



Në bazë të nenit 3, al. 1, pika “b” të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19, al.1, pika “b” të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2004 merr

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË TEATRIT TË OPERËS DHE TË BALETIT DHE TË GALERISË SË ARTEVE NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve të Teatrit të Operës dhe të Baletit dhe të Galerisë së Arteve në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objekteve, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 2735/1, 2375/2, 2735/3, 2727/1, 2730/1, 2733/1, 2734/1, 2734/2, 2735/1, 2735/2 Zona kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe përafërsisht rreth 2.6 ha.

Neni 3

Destinimi i caktuar i lokacionit sipas këtij Vendimi, do të inkorporohet në Planin e ardhshëm rregullativ të hapësirës më të gjerë ku ndodhet ky lokacion.

Neni 4

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit për lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të objektit investiv, për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë të Komunës së Prishtinës do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre të caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. NR. 031-3379 DT. 07.12.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri